

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA MITROVICË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr¹ i prokurimit	642-26-3882-5-1-1
------------------------------------	--------------------------

Sa i përket tenderit për **Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kaqandoll dhe Maxherë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Rahovica Commerce shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Ahmet Kaqiku pa nr.

(Adresa)

Ferizaj

(Vendi)

(Kodi postar)

049-120-969

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fehmi Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rahovicashpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

30.06.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 21.05.2026

Data e planifikuar për hapje 30.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

- Data e planifikuar për hapje 30.06.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Kemi paraqitur kerkes per ri shqyrtim ne AK kerkesa per ri shqyrtim eshte refuzuar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura te LPP nr. 04/L-042 i amadamentuar:

- Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi
- Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 69 – Kapaciteti teknik/profesional
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreevshjeve
- Neni 130 Ndikimi i Paligjshëm

Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik

- Neni 4.3 i rregullores 01/2022 për Prokurim Publik
- Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 97 shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Me datë 14.05.2026, Autoriteti kontraktues – Komuna Mitrovicë, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i rrugëve në fshatin Kaqandoll dhe Maxherë** Nr Prokurimit **642-26-3882-5-1-1** përmes kërkesave kualifikuese kanë kufizuar konkurrencën në atë mënyrë që të lidhet kontratë me kompani të parapercaktuara prandaj bazuar

ne nenin 108/A te LPP-se dhe brenda afatit te parapare me LPP, paraqesim argumentet tona per veprime kundërligjore te AK – Komuna Mitrovicë – Zyra e Prokurimit
Ne si OE te interesuar për këtë procedure te prokurimit te cilet disponojmë me kapacitete teknike dhe profesionale ne afatin e parapare kemi parashtruar kerkese për ri shqyrtim.

Tek Aneksi 7 kerkohen makineri te cilat jane

Eskavator me zinxhir gome, krahe kthyes dhe GPS me peshë min. 18ton

Ne kete kriter Kërkohet kombinim shumë specifik i karakteristikave (zinxhir gome + krah kthyes + GPS + minimum 18 ton) pa lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat reale të projektit Kufizohet konkurrenca pa arsye objektive.

te gjithë eskavoret posedojn pjes ku kthehet krahu. nuk eshte i nevojshem percaktimi i materialit te zingjireeve me gome pasi sipas paramases nuk ka per tu punuar ne qytet por ne rugica te fshatrave.

Eskavator me zingjire pllug dhe riper min. 23 ton

Në pozicionet e paramasës nuk është përcaktuar asnjë kategori specifike e gurit për germim, si dhe nuk është bërë ndonjë specifikim qe do ket nxjerrje te gurit që do të kërkonte domosdoshmërisht riper për eskavator.

Në këto rrethana, vendosja e kërkesave teknike të tilla për pajisje specifike nuk rrjedh nga paramasa dhe përshkrimi i punimeve, por krijon përshtypjen e përshtatjes së kriterëve jashtë nevojave reale të projektit.

Kjo bie ndesh me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilit kërkesat teknike duhet të jenë të bazuara në nevojë reale, të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos kufizojnë konkurrencën apo të favorizojnë operatorë të caktuar ekonomik.

Buldozer me thike levizese dhe kthyes ne dy krahjet me GPS dhe kamera me peshe min.29 ton

Për një rrugë lokale 4 metra të gjerë, ky buldozer është joproportional dhe i panevojshëm dhe se imponimi i pajisjes me GPS dhe kamera është tejet kufizues dhe antiligjor, pasi qe pajisjet e tilla përdoren per punime të rënda të autostradave dhe se për një rrugë lokale 4 metra të gjerë, ky buldozer është joproportional dhe i panevojshëm marre parasysh edhe imponimin e pajisjes me GPS dhe kamera është tejet kufizues dhe antiligjor.

Per cfar eshte e fiksuar pesha min 29 ton Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë arsytim teknik pse kërkohet buldozer me peshë minimale 29 ton dhe me karakteristika specifike (GPS, kamera, thikë lëvizëse dhe kthyes), ndërsa punimet mund të realizohen edhe me pajisje ekuivalente me kapacitete të ngjashme

Kjo kërkesë kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë ju si AK kenë perfunduar me sukses shumë procedure te tjera dhe nuk kane qene keto kerkesa per kritere sic jane ne kete dosje.

Cilinder me teledirixhues, me peshe max 2 ton

Cilindër me teledirigjim, me peshë max. 2 ton i kerkuar ne piken 15 te aneksit 7 tregon për kulmin e urise për përvetesim te parasë publike. Pse i duhet një kompanie një cilindër specifik me teledirigjim pajisje me telekomandë për ngjeshjen e shtresave të një rruge të hapur rurale fshati?

Cilindrato me teledirigjim përdoren në hapësira tejet të rrezikshme, gropat e thella të rrezikuara nga shembjet, tunele, ose afër mureve ku njeriu rrezikohet fizikisht. Përdorimi i këtij kriteri ka vetëm një qëllim eliminimin e 100% të konkurrencës gjegjesisht favorizimin recidiv te te njejtit grup te OE-ve tani e disa vite.

Cilindër me dhëmbëza, vibrues dhe teh per shtrimin e rrugeve me peshë min. 19ton

Per derisa kerkohen 2 buldozher dhe 3 greder pse eshte e nevojshme qe cilindri te ket tehun per shtrimin e rrugeve

Tehu në cilindër është një modifikim specifik i rrallë dhe nuk ka asnjë arsye inxhinierike të kërkohej si kusht eliminues pranueshmërie në një projekt ku tanimë janë kërkuar 3 grejderë me peshë min. 16 ton ne pozicion tjetër të cilët e kryejnë pikërisht procesin e përhapjes dhe shtrimit me teh.

Riper special me vibrim apo qekiq min. 3.5 ton

Kerkesa tjetër për Riper special me vibrim apo qekiq min. 3.5 ton. Edhe kjo kerkese është kerkese anti ligjore. Pse duhet të jetë saktësisht "riper me vibrim" dhe saktësisht min. 3.5 ton ?, kur thyerja e pjesëve të forta ose shkëmbinjve nëse hasen realizohet me qekiq standard hidraulikë të montuar në eskavatorë ashtu edhe sic janë kërkuar 3 cekana për eskavator, Faktimi i peshës fikse 3.5 ton është përcaktuar vetëm për të përputhur kriterin me faturën e blerjes së pajisjes së kompanisë që ka porositur këtë tender dhe të njejten fature neve si kompani e posedojme sipas qasjes në dokumente në procedurë tjetër nga i njejti AK.

Makine për gerryrjen dhe blurje të asfaltit e pajisur me GPS

Si mund të kërkohej një makine për gerryerjen dhe blurjen e asfaltit kur në paramas nuk egziston asnjë pozicion për gerryerjen e asfaltit zyre e prokurimit të AK është ndesh me njesin kerkuese për derisa nuk është parapare gerryerja e asfaltit zyra prokurimit harton kerkesa ku kërkohej gerryese duke i pershtatur kriterin kompanise të cilen e favorizon.

Kerkesat e tilla janë diskriminuese përkatësisht favorizuese, madje aplikimi i tillë lajthit operatorët ekonomik të cilët i posedojnë të njëjtat kapacitete por me dokumente unike doganore apo edhe paisje tjera të përcaktuara nga pozicionet të aneksit 7, prandaj kerkesa për libereze çarkullimi rrugore duhet të largohet nga kerkesa kualifikuese mece pergjegjesia e homologimit të paisjeve të punes nuk bie në juridiksion të LPP-se por është e rregulluar me ligje tjera.

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kriterëve apo dëshmime jo në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njesisë së kërkesës.

Te gjitha këto shkelje ligjore janë konsumuar nga zyra e prokurimit dhe në si OE kemi prova të mjaftueshme për tentativa të lemimit të konkurrencës perkatesisht favorizim të kompanis se caktuar.

Këto paisje teknike të aplikuara dhe të kerkuara qoin në kufizim të konkurrencës dhe si të tilla shkelin parimet e prokurimit publik.

Sa i përket kerkesave të kapaciteit teknik dhe profesional ju si AK, dhe zyrtaret përgjegjës të prokurimit, para publikimit të njoftimit për kontrate dhe dosjes së tenderit do duhej të referoheshir nenit 69 të LPP-se, pastaj të aplikoni kerkesa të tilla.

Me dispozita ligjore çdo AK e ka pergjegjesi të mos ben diskriminim në kriteret e prokurimit sepse kjo ndikon në demtimin e buxhetit publik dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-se dhe Rregullores nr.01/2022 të Prokurimit Publik.

Neni 17.17 i kësaj Rregullore e përcakton qartë se AK nuk duhet të diskriminojë OE dhe të mos e kufizojnë konkurrencën.

17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:

a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose

b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Duhet të hiqen kriteret e lartshenuara sipas tabelarit të paraqitur sepse janë të panevojshme dhe favorizuese

Te gjitha provat dhe deshmit e prezantuara si me sipër tregojne qe AK- Zyra e Prokurimit, haptazi ka krijuar kerkesa favorizuese te cilat qojne ne favorizim te operatoreve ekonomik te caktuar, sepse te njejtat janë kerkuar duke perdorur vlera fikse, minimum dhe maksimum te vlerave ne raste te caktuara, percaktim te materialeve te paisjeve siç është (zingjir gome) Percaktimet e tilla janë te ndaluara, pershtatja, fiksimi dhe percaktimi i paisjes apo i dimensioneve te pajisjeve specifike te caktuara.

Dhjetra paisje te aplikuara ne këtë procedure disponohen vetëm nga një OE i caktuar, prandaj ne si OE kërkojmë qe me rastin e trajtimit te kesaj kerkese te merren parasyshe deshmit provat dhe baza ligjore dhe te respektohet paragrafi 6 i nenit 108/A te LPP-se, ne te kundërtën ne si OE gjetjet dhe provat - dëshmitë do ti raportojmë ne agjensite perkatese te cilat monitorojn procedurat e prokurimit dhe te cilat kane përgjegjësi për procedurat e prokurimit.

Poashtu edhe neni 4.3 i rregullores 01/2022 per prokurim publik thote:

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efektive dhe me efektive.

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paratë për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/ Mos-diskriminimi – Të vepohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial.

Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

d. Objektivitet/ Integritet/ Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefite të çfarëdo lloji nga Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.

Ndërsa neni 7 i LPP-se poashtu e sqaron shume qarte se AK, nuk i lejohet te aplikojë kriteret diskriminuese:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatoreve ekonomik.

4. *Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.*

Prandaj, bazuar ne atë që u përshkrua si me larte, përkatësisht me kriteret kualifikuese të tilla, përveç që shkelen dispozitat ligjore të prokurimit publik shkelen parimet baze siç është mos favorizimi apo diskriminimi, shkelet kodit etik i prokurimit publik shkelet edhe vet etika profesionale, prandaj, kompania jone kërkon nga zyra e Prokurimit të AK – Komuna Vushtrri që të nxjerre këtë:

V E N D I M

- I. Të aprovohet** ne tërësi kërkesa jone për ri shqyrtim si e **bazuar**
- II. Të largohen kërkesat** e kontesura dhe të konstatuara si të kunderligjeshme
- III. Të percaktohen kërkesa ligjore** të bazuara ne dispozita ligjore dhe të aplikohen kërkesa relevante dhe proporcionale ne raport me aktivitetin e prokurimit siç percaktohet me nenin 27 dhe 52 dhe dispozita tjera të LPP-se.
- IV. Të nxjerrët, njoftim mbi korrigjimin** e gabimit dhe të zgjatet afati për ofertim bazuar ne nenin 53.7, të LPP-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te pa kalkuluar deri me tani

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) *bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit ne përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*